



Këshilli
Shqiptar
i **Medias**



Ky projekt
financohet nga
Bashkimi
European

Shkeljet e Etikës në Median Online



KONTEKSTI MEDIATIK

- Besohet që mbi 700 media operojnë sot në Shqipëri.
- Shumica e tyre (rreth 650) janë media që operojnë ekskluzivisht online.
- Edhe mediat e tjera, TV, radio apo shtyp, shpërndajnë informacion edhe online.
- Por, nga një hulumtim i bërë në muajin nënor 2019 nga KShM Alexa rendit vetëm 34 portale lajmesh ndër 300 faqet më të klikuara në Shqipëri.
- Ndërkohë është e pamundur të merret informacion se cila është arritshmëria mediatike përmes faqeve të informacionit në FB.



KONTEKSTI PROFESIONAL

- Obeziteti mediatik ka deprofesionalizuar gazetarinë.
- Shkolla profesionale e gazetarisë e ka të pamundur të furnizojë me profesionistë gjithë mediat. Shkolla vetë ëshët e orientuar më shumë drejt PR-it sesa raportimit, për shkak të “kërkesave të tregut”.
- Shumë nga vendet kyçe ku përpunohet informacioni, operohen nga jo-profesionistë të cilët paguhen shumë pak dhe nuk janë të organizuar në sindikata.
- Kriteri profesional përballë atij komercial nuk është i rëndësishëm as për pronarët e mediave.
- Roli publik i medias është në zhdukje e sipër përballë rolit të saj si biznes fitimprurës.
- Media publike nuk po arrin të gjejë tregun e vet.
-



KONTEKSTI SHOQËROR

- Opinioni publik bombardohet përditë nga një larmi në të shumtën e rasteve e pakonfirmueshme informacioni.
- Mungesa e mbrojtjes së copyright ka bërë që ajo çfarë publikohet të jetë thuajse e njëjtë në të gjitha mediat. Ndryshim bëjnë vetëm opinionet politike.
- Inflacionimi i mjeteve të mass medias, e ka zhdukur konceptin e referencës ndaj tyre.
- Për shkak të teprisë me mjete informacioni, publiku mesatar e ka të vështirë të krijojë besim.
- Informacioni dhe media tashmë perceptohen si koncepte abstrakte.
- Autoritete me prirje totalitare, trimërohen për të deligjitimuar rolin publik të medias.



PËR PUBLIKUN APO PËR PRIVATIN?

- Për vite me radhë, liçencimi i mediave nuk i nënshtrohet asnjë kriteri mbi rolin publik.
- Një portal mund të regjistrohet brenda ditës në Shqipëri dhe kushton vetëm 200 lekë.
- Tregtarët e informacionit që shqiptarët i hedhin trurit, nuk kanë asnjë detyrim.
- Media perceptohet dhe trajtohet vetëm si mjet fitimi direkt ose përmes influencës.
- Vullneti politik nuk shkon në drejtim të fuqizimit të publikes dhe anon më tepër drejt tentativës për të “joshur” manjatët e medias.



ENTERTAINMENT, INFOTAINMENT, EDUTAINMENT

- Veç rolit informues, edhe roli edukues i medias është tërësisht në hije.
- Roli argëtues po zgjeron terren për shkak të fluiditetit, garancisë së fitimeve.
- Gjithashtu argëtimi, entertainment, po gllabëron gradualisht edhe informacionin, edhe prej faktit që cilësia e raportimit ka rënë e po shkon drejt zhdukjes..
- Informacioni rozë, showbiz, lajme të pakualifikueshme si lajme, përmbysin mediat.
- Investigimi është në nivele të ulëta, ndërsa dhe raportimi bëhet më tepër nga “tavolina”.



Pse kaq shumë shkelje?

Një nga arsyet pse kemi kaq shumë shkelje vijnë dhe nga 3 “streset” e gazetarit shqiptar.

Puna e çdo gazetari çenohet nga 3 elementë stresues, që të bërë bashkë shkaktjnë më e pakta një mungesë profesionalizmi në produktet mediatike, por që shkon deri në prodhim dizinformacioni.

- **Pronarët.** Gazetarët shqiptarë sot janë nën presion të vazhdueshëm nga pronarët e mediave të cilët kanë marrë rolin e Krye-Kryeredaktorit, futen në redaksi, japin orientime dhe mbi të gjitha kërkojnë që mediat t’i shërbejnë agjendave të tyre ekonomike, politike ose personale, zakonisht në kurriz të cilësisë së informacionit dhe profesionalizmit. Jo rrallë, presioni i pronarëve për klikime e audiencë i detyron ata të abuzojnë me etikën e raportimit.
- **Sindikatat.** Mungesa e sindikatave të mirëfillta ka bërë që gazetarët të jenë të paorganizuar për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe të mos kenë kontrata që t’i mbrojnë nga presioni e abuzimi. Ata janë të pafuqishëm dhe të pabashkuar çfarë e bën të vështirë rezistencën ndaj presionit të pronarëve.
- **Kushtet e punës.** Shpesh gazetarëve u kërkohet të punojnë me normë dhe të prodhojnë aq shumë lajme sa e bën të pamundur që ata të prodhojnë raportim cilësor. Shpesh, ritmi i prodhimit të lajmeve, sidomos të mediat e reja, nuk u jep mundësinë që të verifikojnë lajmin, ose i detyron të “gjejnë” lajme aty ku nuk ka.



2 llojet kryesore e Shkeljeve të Etikës

Shkeljet nga pakujdesia

- Disa shkelje etike ndodhin nga pakujdesia, nga neglizhenca apo thjesht nga injoranca e atyre që punojnë si gazetarë. Pavarësisht nga kjo, dëmi që ata mund t'i shkaktojnë qytetarit mund të jetë i madh.

Shkeljet e qëllimta

- Shkeljet e qëllimta të etikës bëhen për shkak interesash personalë, ekonomikë ose politikë të pronarëve, kryeredaktorëve e ndonjëherë dhe gazetarëve.
- Dëmi i shkaktuar nga ky raportim joetik jo vetëm tek një individ, por dhe tek publiku në tërësi mund të jetë i madh.



Qasja Monitoruese e Projektit

Në kushtet e krijuara, monitorimi që KSHM ka bërë kishte si qëllim:

- Së pari, të tregojë qëllimin pozitiv.
- Së dyti, të dëshmojë paanësinë e tij.
- Së treti të kryhet me sa më shumë profesionalizëm.
- Së katërti të ketë rezultate konkrete.
- Së pesti të ofrojë mundësi për përmirësim.
- Dhe e fundit, të krijojë një bazë të dhënash mbi të cilat të mund të ngrihet një strategji e qartë e KSHM dhe e Aleancës për Media Etike, të sapoformuar për të zvogëluar numrin e shkeljeve dhe për të ngritur një ndërgjegje etike tek gazetarët.



Metodologjia e përdorur

KSHM vendosi të fokusohet në mediat që renditen të parat në listen e rankimeve të websajtit ALEXA. Ne e blemë informacionin që është i rezervuar dhe na rezultoi që në 300 websitet më të klikuara në Shqipëri, vetëm 34 janë portale informacioni. KSHM mori 30 të parat nën monitorim.

Pavarësisht renditjes në Alexa, klikimi në rrjetet sociale mund ta përmbysë këtë renditje. Por, për momentin është e pamundur të kemi informacion për aritshmërinë e një medie në rrjetet sociale, sepse ky informacion duhet të na jepet nga vetëmediat, gjë që rezultoi e pamundur.

Mediat e monitoruara:






Nenet e Kodit të Etikës

1. Saktësia dhe Ndershmëria e Informacionit
2. Dallimi i Faktit nga Opinioni
3. Korrektimi dhe Replika
4. Marrëdhëniet me Burimet
5. Pavarësia editoriale
6. Marrëveshja para Publikimit
7. Përgjegjësia pas Publikimit
8. Gjuha e Urrejtjes
9. Ndërhyrja në jetën private
10. Konflikti i Interesit
11. Nxitja e Krimin dhe Dhunës
12. Raportimi i aksidenteve dhe fatkeqësive
13. Raportimi i Procedurave Gjyqësore dhe Prezumimi i Pafajësisë
14. Mbrojtja e Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara
15. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale
16. Marrëdhëniet mes Gazetarëve



SHKELJET MË TË SHPESHTA

sipas neneve të Kodit të Etikës



Kjo pasqyrë e shkeljeve të etikës flet qartë për situatën e mediave shqiptare.

Në monitorim ne kemi shkëputur më vete (nën 1.1) një nga format më të zakonshme të mashtrimit të publikut për arsye klikimesh: mospërmendja e vendit ku ka ndodhur ngjarja në titull. Pra, ngjarje që ndodhin larg Shqipërisë por që nga titujt publiku joshet të mendojë se ndodhin këtu


afër.

Pavarësia editoriale është e ulët, ndërsa Dallimi i Faktit nga Opinioni është një tjetër shenjë që gazetaria shqiptare është e pandershme ndaj publikut, me gati 1.5 shkelje në ditë. Arsyeja është që shkelja e këtij neni tregon tentativën që raportimi të mos jetë i paanshëm por “të pasurohet” me opinionin e atij që raporton duke manipuluar lexuesin. Vërehet një ulje



Renditja e shkeljeve sipas mediave

Dhjetor 2019-Mars 2020




Sasia e shkeljeve në këtë grafik NUK TREGON se cila medie është më joetike se tjetra, pasi numri i monitoruar i shkeljeve varet nga sasia e lajmeve që prodhon çdo media në ditë. Mediat me më shumë prodhim kanë tendencën të kenë numër më të lartë shkeljesh. Aktualisht është e pamundur të ngrihet një sistem monitorues që të mund të përqasë shkeljet etike në raport me numrin total të lajmeve të botuar nga një media.



SHKELJA MË E SHPESHTË:

Dallimi i Faktit nga Opinioni




Dallimi i Faktit nga Opinioni është një shkelje e rëndë sepse ajo është shkelje e qëllimtë për të ndikuar në opinionin publik përmes lajmeve që mbushen dhe me komente politike. Interesante është që agjensi lajmesh si Balkanweb e kanë shumë të ulët këtë shkelje, pikërisht sepse ato thjesht raportojnë lajme. Po ashtu, 3 nga mediat më të rankuara nga Alexa, si Syri,

Lapsi dhe Tema janë ndër shkelësit më të mëdhenj të këtij neni*. Ajo që vihet re në përgjithësi është që sa më të pozicionuara politikisht ëq të jenë mediat aq më shumë shkelje të këtij neni bëjnë.



SHKELJA Ë DYTË MË E SHPESHTË:

pavarësia editoriale




Pavarësia Editoriale është një nga problemet e mëdha të mediave shqiptare. Ajo shfaqet në 2 forma kryesore që mund të verifikohen nga monitorimi: së pari përmes artikujve që nuk janë raportim por në të vërtetë reklama të fshehta; e dyta përmes shkrimeve të porositura ose lajmeve të gatshme që vijnë nga Qeveria, Bashkia e Tiranës ose Patitë Politike.

Kryesimi nga ana e Balkanwebit ka të bëjë dhe me grupin e biznesit ku kjo media bën pjesë, dhe bizneset e të cilit mbulon me lajme-reklamë. Numri i lartë mund të krahasohet në mënyrë empirike dhe me sasinë e reklamave që ka një media.



SHEMBULL:

Gjuha e urrejtjes




Gjuha e Urrejtjes në përgjithësi vjen e kamufluar. Falë dhe ekzistencës së një Komisioneri Kundër Gjuhës së Urrejtjes, në përgjithësi ajo përqendrohet tek provokimi i mesazheve të përdoruesve poshtë shkrimeve dhe jo në përmbajtjen e artikujve. Rastet e paraqitura me shumë gjasa tregojnë mediat ku ka gazetarë të paditur të cilët nuk e kuptojnë mirë gjuhën e urrejtjes në termat e titujt që përdorin.



Shembull:

Saktësia e informacionit




Ky është një tjetër nen i rëndësishëm që shkelet rëndom. Shkeljet e nenit të Saktësisë së Informacionit dhe të Gazetarisë së Paanëshme kanë një shtrirje të gjërë, që nga mospërmendja e vendit në titull për të kapur klikime, tek mos verifikimi i burimeve, tek botimi i thashethemeve si lajme e deri tek mos verifikimi i lajmit me një burim të dytë. Kjo është një shkelje shpesh që vjen nga neglizhenca, nga mungesa e

profesionalizmit ose nga mbingarkesa e gazetarëve. Por jo rrallë ajo vjen si shkelje e qëllimtë, me qëllim dezinformimin e publikut.

SHEMBULL:

Raportimi i Procedurave Gjyqësore dhe Prezumi i Pafajësisë




Raportimi i procedurave gjyqësore dhe prezumimi i pafajësisë, një “gangrene” e raportimit online ka pasur një rënie gjatë këtyre 4 muajve krahasuar me monitorimin e një viti më parë. Arsyeja është edhe një fushatë agresive nga ana e KSHM por dhe si pasojë e on-job training të zhvilluar nga KSHM. Mediat që kanë pasur on-job training me KSHM pothuajse nuk gjenden fare në këtë listë.

Në krye të listës qendrojnë mediat që janë më të orientuara tek raportimi i krimeve apo kronikës së zezë. Mediat jo prezente mundet dhe që të mos e kenë prioritet raportimin e kronikës, ndaj nuk figurojnë me shkelje. Githsesi, shkelja e këtij neni nuk varet nga sasia e shpejtësia e prodhimit por nga profesionaliteti i medias.



Shkeljet Sipas Muajve

Dhjetor 2019



Dhjetori paraqet pak shkelje në raport me muajt e tjerë të studimit, edhe sepse si sezon festash ka një mbingarkesë produktesh jo-politike, çka e "zbut" dhe pakëson 'agresivitetin' mediatik krahasuar me muajt e tjerë. Këtu numrin më të madh të prodhimit mediatik e përbëjnë akoma lajmet rozë, e të cilat nuk monitorohen.

Pavarësia editoriale është shkelja më kryesore, e shkaktuar nga numri i lartë


i reklamave okulte.

Interesant është fakti që shkelja e etikës në raportimit e Procedurave Gjyqësore dhe Prezumimin e Pafajësisë ka një rënie drastike në Dhjetor, që mund të shpjegohet vetëm me një rënie të përkohëshme të raportimit në tërësi të kriminalitetit.



Shkeljet Sipas Muajve

Janar 2020




Janari i këtij viti ka një rritje të shkeljeve, po kryeson shkelja që ka të bëjë me “peshkimin” e klikimeve, mos përmendja në titull e vendit ku ka ndodhur ngjarja. Kemi një rikthim të raportimit joetik të kronikës së zezë dhe procedurave gjyqësore. Pavarësia editoriale ka një rënie, ku shkak është dhe mbarimi i festave dhe mbyllja e fushatës së marketingut.



Shkeljet Sipas Muajve

Shkurt 2020




Në shkurt Pavarësia editoriale qendron lart, edhe pse e tejkaluar nga shkelja e Dallimit të Faktit nga Opinioni, për shkak të sezonit politik të ngarkuar.

2 elementët bazë që mund të monitorohen këtu për Pavarësinë editoriale, reklamën e fshehtë dhe artikujt e paguar ose të furnizuar në mënyrë sistematike nga politika vazhdojnë në mënyrë konstante për gjatë gjithë vitit.



Shkeljet Sipas Muajve


Mars 2020



Për sa i përket rënies së numrit të shkeljeve në mars kjo mund të ketë disa arsye, ku kryesorja është që fillimi i pandemisë dhe kufizimi i i aktiviteteve dhe i raportimeve nga terreni. Më pak raportim, do të thotë më pak shkelje në total. Ndërsa renditja e shkeljeve ruan trendet e njohura, me një rënie të shklejes së pavarësisë editorial dhe për shkak të sezonit të dobët të marketingut si komercial dhe politik



Shkeljet e mediave të Reja




Mediat e reja të monitoruara kanë probleme të mëdha me përzierjen e faktit me opinione, tentativa manipuluese e publikut. Saktësia e informacionit dhe dallimi i faktit nga opinioni, janë shkelje etike që KSHM i konsideron nga më të rëndat pasi në të dy rastet manipulojnë me informacionin. Një shkelje tjetër masive e cila bëhet vetëm për të arritur klikime është dhe

mospërmendja e vendit në titull, nga e cila ka çdo ditë një shkelje vetëm në mediat e reja të monitoruara.



Shkeljet në krahun dixhital të gazetave




Shumica e gazetave kanë kaluar vetëm online në këto 3-4 vitet e fundit (ndër to Mapo, Shekulli, etj). Por edhe gazetat që vazhdojnë akoma në qarkullim (Dita, Panorama, Tema, etj) pjesën më të madhe të audiencës e kanë tashmë online. Edhe për top vërehen të njëjtat probleme si tek mediat e reja, kryesisht me pavarësinë editoriale, saktësinë e informacionit

dhe dallimin e faktit nga opinioni, shkelje etike që siç thamë dhe më herët KSHM i konsideron nga më të rëndat pasi në të dy rastet manipulojnë me informacionin.



Shkeljet në portalin online të Televizioneve




Sipas grafikëve për muajt dhjetor '19 –mars '20, problemi më i madh i portaleve të televizioneve është pavarësia editoriale, ku spikasin 2 elementë: shkrimet e gatshme nga politika ose pushteti dhe reklamata e fshehta. Duke qenë se ato shërbejnë më tepër si përforcues edhe vizual (audio/video) i produkteve të televizioneve përkatës, në artikujt e shkruar këto

media ato nuk kanë të njëjtat shkelje si portalet e gazetatat, psh ndarja e faktit nga opinioni apo raportimi i procedurave gjyqësore. Gjithsesi, duke qenë se ato kanë një volum të madh të artikujve të përkthyer sipas shkeljes së nenit të Mospërmendjes së Vendi ku ka ndodhur ngjarja në titull.



Ndarja sipas llojeve të medias



Kjo është shpërndarja e shkeljeve sipas llojeve të medias:- portale, gazeta dhe TV (faqet online).

Në dukje shkeljet e portaleve përbëjnë pjesën më të madhe, gati 62% të shkeljeve. Por, këtu duhet theksuar se një pjesë e madhe e materialeve të tyre janë transkripte televizive (lajme, intervista, debate) ku këto të fundit nuk janë objekt i këtij studimi.

Portalet e televizioneve kanë përqindjen më të ulët të shkeljeve, kjo sepse siç e thamë në to mbizotëron më shumë produkti audio/video që nuk është pjesë e këtij monitorimi.

Ndërkohë përqindja e lartë e shkeljeve të portaleve të gazetave vjen si pasojë e lexueshmërisë dhe audiencës që ato kanë arritur të mbartin dhe online por dhe prodhimitarisë së mirë (më shumë prodhimtari - më shumë shkelje).



Ky projekt
financohet nga
Bashkimi
European

Ky studim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit European.
Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij studimi është e Këshillit Shqiptar të Medias
dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit European.